



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7388/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40.2, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.7703/2018 neni 79, 80, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2022 merr:

VENDIM
PËR PLOTSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE
PËR VITIN 2023

1. Me këtë vendim aprovohet plotësim ndryshimi i rregullores për taksat komunale për vitin 2023.
2. Plotësim ndryshimi i rregullores për taksat komunale për vitin 2023 lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Zhvillim Ekonomik t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe ekzekutivin e komunës dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e rregullores për taksat komunale për vitin 2023.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plotësim ndryshimi i rregullores për taksat komunale.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet përkatëse),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.08.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6387/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40 , Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2022 merr:

V E N D I M
PËR PLANIN E INTEGRITETIT PËR VITET 2022-2026

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për Planin e Integritetit për vitet 2022-2026.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani e Integritetit për vitet 2022-2026.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.08.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.6388/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2022 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR TRE KOMITETET KONSULTATIVE PËR
VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për tre komitetet konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2022 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për komitetin konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për komitetin konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komitetet Konsultative
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 08. 2022

